



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-5522/2018
Kaçanik, 28.02.2018

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e II (Dytë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik (Legjislatura e VI-të), mbajtur më datë 28 Shkurt 2018.. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarët, pjesëmarrës në mbledhje ishin 27 anëtarë- të gjithë anëtarët.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Nënkyetari i Komunës –Ylber Bajra, drejtoret e drejtive komunale: Bahri Selimi, Fatmir Loku, Festim Neziraj, Zahir Doda, Ukshin Qallaku dhe Ramadush Osmani.

Nga Mbledhje morën pjesë, Bejtulla Dalloshi, zyrtar i IT.

Mbledhja u monitorua përmes Tel-prezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të KK në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës, Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari i përshëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, kuorumi ekziston me u mbajtur mbledhja, kushte pune ka, andaj e hapi mbledhjen e II (Dytë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2018, data; 28 Shkurt, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e I (Parë) e rregullt e Kuvendit të Komunës;
2. Propozim Vendimi për Plotësimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
3. Rishqyrtimi i Vendimit të KK për formimin e Komitetit të Komuniteteve;
4. Propozim Vendimi për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB);
5. Propozim Vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të paspenzuara nga vitet paraprake, për shpenzim me buxhetin e vitit 2018;
6. Propozim Vendimi për Themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRU “Bifurkacioni” – Sh. A. Njësia në Kaçanik;
7. Propozim Vendimi për Themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM “Pastërtia” – Sh. A. Njësia në Kaçanik;
8. Propozim Vendimi për Themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për NPK “Stacioni i Autobusëve” SH.A. Kaçanik;

8. Propozim Vendimi për Themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për NPK “Stacioni i Autobusëve” SH.A. Kaçanik;
9. Propozim Vendimi për formimin e Komisionit për emërimin dhe riemërimin dhe shqyrtimin e ankesave të rrugëve lokale;
10. Propozim Vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm të pjesës së parcelës kadastrale Nr. 00246-0, Z.K Soponicë, e evidentuar në emër të Esat Xhemal Guri nga f. Nikaj, për zgjerimin e lokacionit të varrezave të dëshmorëve;
11. Propozim Vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm të parcelës kadastrale Nr. 01507-0 në vendin, “Guri i Zi” Z.K Biçec, PSH, Ekonomia Pyjore në Kaçanik, për ndërtimin e objekteve publike;
12. Propozim Vendim paraprak për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, parcela kadastrale Nr. 00565-0, Arë e klasës të 3 (Tretë) ,ZK Bob, në emër të Esat Dema
13. Propozim Vendim paraprak për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, parcela kadastrale Nr. 00203-5, Arë e klasit të 3 (Tretë) ,ZK Bob, në emër të Kemajl Dema; dhe
14. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të ngastrave kadastrale 183-2; 183-1; 182-0; 180-6; dhe 180-7, në ZK Bob, nga toka bujqësore në tokë ndërtimore- zonë ndërtimi, banim e afarizëm.

Lidhur me Rendin e propozuar të punës u hap diskutimi:

znj. Kaltrina Tafili, Nga rendi i punës shihet se nuk është përfshirë, Kërkesa një grupi iniciues për themelimin e Teatrit të qytetit të Kaçanikut. Me intereson të dijë se ku ka ngelur procedura lidhur me këtë çështje

z. Ekrem Kyçyku, Kërkoj të hynë në Rend pune, Informatë për gjendjen e krijuar gjatë vërvshimeve nga të reshurat atmosferike dhe hapat të cilët janë marrë nga organet komunale për sanimin e gjendjes.

z. Bekim Koxha, Kërkoj që në çdo mbledhje të Kuvendit të Komunës, në rend pune të jenë edhe pika; Të Ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit, Lidhur me propozimin e z. Bekim Koxha, theksoj se e kemi pozicionin e Pyetjeve dhe Kërkesave, ku mund të i adresojmë çështjet, ndërkaq iu njoftoj se pika të ndryshme nuk do të kemi. Është Rregullorja e Punës së Kuvendit të Komunës që i përcakton këto çështje, andaj iu kisha lutar t'i përbahemi të njëjtës. Për çështjen e Teatrit të qytetit të Kaçanikut të cilën e ngriti znj. Kaltrina, unë kam kontaktuar me grupin iniciues dhe në momentin që lënda të kompletohet, do të jetë në KK dhe besoj se askush nuk do të jetë kundër themelimit të teatrit.

Ndërkaq, për propozimin e z. Ekrem Kyçyku, unë e konstatoj se për këtë pikë duhet me pasur material, kështu është mirë që kjo pikë të mbetet për mbledhjen vijuese të KK. Për këtë mbledhje nuk kemi material, kështu drejtori i drejtorisë për mbledhjen vijuese përgatitet me Raport dhe mund ta kemi në rend pune.

Të gjithë anëtarët e KK, u pajtuan që çështja e vërvshimeve nga të reshurat atmosferike të ngelë për mbledhjen vijuese të Kuvendit të Komunës.

Meqë nuk ka kush diçka tjetër, atëherë Rendin e Punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e ,

APROVOJ

Rendin e Punës në Përbërje 14 pikave.

Me konstatim që për mbledhjen vijuese të Kuvendit të Komunës, DSHPE, të përgatit një Raport për gjendjen para dhe pas vërvimeve nga reshjet atmosferike që kishte në Komunën e Kaçanikut.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e I (Parë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës;

Vërejtje në Procesverbal paraqiti z. Adnan Reka, në tri pikë të diskutimit të mbledhjes, të cilat vërejtje me vonë i janë sjellë me shkrim Sektorit të Kuvendit dhe janë inkorporuar në Procesverbalin e mbledhjes.

Procesverbal i mbledhjes së I-r (Parë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës u miratuar njëzëri pa ndonjë vërejtje tjetër. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

APROVOJ

Procesverbalin nga Mbledhja e I (Parë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë: 24 Janar 2018/ Lënda : 01Nr. 60/01-1946/2018.

PYETJE dhe KËRKESA

z. Nexhat Luku, Shprehi shqetësimet e tija për punimet e Autostradës, Prishtinë-Shkup, pjesa nga Gërlica në Kashan, ku janë bërë dëme të konsiderueshme dhe nuk e di se kompania ‘Bektel Enka’ a ka leje me bërë çka të donë dhe me i dëmtuar pronat shtetërore e private. Unë mendoj se në këtë drejtim duhet të formohet një Komision nga radhët e anëtarëve të KK dhe të Ekzekutivit të Komunës që t’i evidentoj demet dhe të bëjë një Raport për demet e shkaktuara dhe ai Raport t’i dërgohet, Ministrisë së Infrastrukturës, sepse demet e shkaktuara në fund dihet se bien në kurrit të komunës tonë.

znj. Nazife Krasniqi, 1. Kërkoj nga Kryetari i Komunës me na njoftuar se a janë marrë veprime të nevojshme për sanimin e gjendjes të rrugës “ Agim Bajrami.

2. Kërkoj një Raport me shkrim nga DSHMS lidhur me kontrollimin e grave me aparatin, Mamograf, i cili ka qenë disa ditë në shërbim në QKMF në Kaçanik, në mënyrë që të dimë, sa gra janë kontrolluar dhe a ka mundësi që një kontroll e tillë të përsëritet edhe një herë.

znj. Arlinda Rakoci-Raka, Në lagjen ku unë jetoj, me konkretisht në rrugën “ Sali Bajra” ka një muaj që nuk ka ndriçim elektrik. A ka mundësi me u marrë ndonjë veprim i nevojshme në këtë drejtim nga dikasteri përkatës për me sanuar gjendjen e ndriçimit elektrik në atë pjesë.

z. Bekim Koxha, A ka diçka lidhur me dëmet që ka shkaktuar kompania “ Bektel Enka” me konkretisht në mbylljen e rrugës në Doganaj për gjatë zhvillimit të punimeve?

z. Ekrem Kyçyku, Banorët e lagjes “ Mejdi Dalloshi” të qytetit të Kaçanikut, kanë bërë një Kërkesë për sanimin e gjendjes së rrugës në atë pjesë. Me intereson të di, a ka diçka në këtë drejtim?

Kryesuesi i Kuvendit, Dha sqarime për çështjen e ngritur në mbledhjen e kaluar nga Ekrem Raka për krijimin e kushteve të sallës së KK. Dihet se Salla e kuvendit kështu si është nuk i plotëson kushtet për mbledhje. Ne jemi duke munduar me bërë diçka, por për momentin nuk kemi mjete të mjaftueshme. Nëse ka kush ndonjë ide, do t'i marrim parasysh edhe idetë e juaja..

Të çështja të cilën e pat ngritur ngrit, Shpend Krusha për një familje në gjendje të rëndë në f. Sllatinë, iu njoftoj se kompania “Bejta Comerc” që dy vite është duke ia siguruar bukën asaj familje. Ne do të mundohemi me bërë diçka për atë familje për banim social, por çështja është se ajo familje nuk po lëvizte nga aty.

2. Propozim Vendimi për Plotësimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;

Kryesuesi i Kuvendit, Ne e kemi marrë shqyrtimin e Ligjshmërisë nga MAPL për këtë pikë, ligjshmëria është në rregull, ndërkaq kërkoj nga dy subjektet politike të cilat nuk i kanë dhënë emrat për përfaqësim në këtë komitet, t'i jepin propozimet konkrete për përfaqësim në KPF. Për këtë pikë e hapi diskutimin:

z. Ekrem Raka, Ne si opozitë i kemi bërë shkressë MAPL për përfaqësimin e të gjitha subjekteve politike në KPF. Përgjigjen që e kemi marrë nga ky organ, nuk jemi të kënaqur. Për këtë arsyе kur të votohet kjo pikë, unë do të abstenoj.

z. Ekrem Kyçyku, Edhe ne si LVV, nuk jemi kënaqur me shkresën e MAPL për mos përfaqësimin e të gjitha subjekteve politike në KPF.

Kryesuesi i Kuvendit, Kërkoj nga LVV dhe LDK t'i jepni emrat për përfaqësimin e tyre në KPF, ndërkaq duhet bëhet balancimi gjinor, kështu është mirë njëri subjekt politik të propozoj një femër për anëtarë të KPF.

z. Shpend Krusha, Nga LVV për anëtarë të KPF e propozojmë të jetë, Ekrem Kyçyku,

znj. Arlinda Rakoci-Raka, Në emër të LDK, për anëtarë të KPF e propozojmë të jetë, Selim Reka.

z. Selim Reka, Balancimi gjinor po kërkohet në Komitete, ndërkaq Ekzekutivi i Komunës nuk ka balancim gjinor dhe kjo nuk po paraqet problem për nivelin qendror.

z. Shemsedin Luzha, Ne subjekti politik i AAK, për shkak se po kërkohet me u bërë balancimi gjinor në KPF, e tërheqim anëtarin tonë, Hajredin Luta nga KPF për të zëvendësuar me, Albana Troni nga AAK.

Propozimet që dolën u shtruan në votim dhe të njëjtat u miratuan me shumicën e votave Për, Kundër votë nuk pati, Abstenoj, Ekrem Raka. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës, mori këtë:

VENDIM

Për ndryshim plotësimin e KPF, ashtu që në KPF emërohen anëtarët:

1. Ekrem Kyçyku nga LVV,
2. Selim Reka nga LDK,

- 3. Nga KPF hiqet, Hajredin Luta për t'u zëvendësuar me Albana Troni, për shkak të balancimit gjinor.**

Me Vendimin e ndryshuar për formimin e KPF të datës 24 Janar, 2018, tanë e tutja nga data e marrjes së këtij vendimi, KPF është me këtë përbërje:

1. Kemal Mërseli,	nga PDK	Kryesues sipas funksionit,
2. Nexhat Loku	nga PDK	anëtar,
3. Pranverë Loku-Zharku,	nga PDK	anëtar,
4. Ekrem Kyçyku	nga LVV	anëtar,
5. Selim Reka	nga LDK	anëtar,
6. Albana Troni	nga AAK,	anëtar, dhe
7. Hafize Sallahi	nga NISMA	anëtar.

- 3. Rishqyrtimi i Vendimit të KK për formimin e Komitetit të Komuniteteve;**

Kryesuesi i Kuvendit, Shkresa na ka ardhur nga MAPL, duhet të bëhet balancimi gjinor në këtë komitet, kështu duhet të bëjmë ndryshime. Për mos me i hequr ata që janë, unë kam menduar me shtuar numrin edhe për dy anëtarë, nga 5 anëtarë sa ishte të bëhet me 7 anëtarë dhe atë; 1 anëtar prej KK nga subjekti politik i AAK dhe 1 anëtar nga OJQ. Unë kam menduar me qenë nga OJQ e Kryqit të Kuq. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Nexhat Loku, Në emër të grupit parlamentar të PDK, konfirmoj se jemi për me u shtuar numri i anëtarëve në këtë komitet.

z. Ekrem Kyçyku, Në emër të grupit parlamentar të LVV, konfirmoj se do të Abstenojmë, kur kjo çështje të dal në votim.

z. Shemsedin Luzha, Në emër të AAK, konfirmoj se jemi me u shtuar numri i anëtarëve në këtë komitet.

z. Bekim Koxha, Ne subjekti politik NISMA, jemi për atë që me u përfshirë edhe NISMA në këtë komitet.

z. Ekrem Raka, Me sa e di unë, Kryqi i Kuq, nuk është Organizatë Joqeveritare(OJQ).

z. Shpend Krusha, Kryqi i Kuq është OJQ, por çështja është së, ne dashur me herët me i ditur emrat, sepse për këto arsy, ne po detyrohemë me abstenuar në këtë çështje.

z. Ekrem Raka, Nuk jam i sigurt se a është Kryqi i Kuq Organizatë Joqeveritare(OJQ) apo Organizatë Qeveritare(OQ) kështu unë tërhiqem nga mendimi im që e potencova me herët.

Nënkyetari i Komunës-Ylber Bajra, Nga OJQ, e propozoj për anëtar të Komitetit për Komunitete të jetë, Naim Hysa nga Kryqi i Kuq.

z. Shemsedin Luzha, Nga AAK, e propozoj për anëtar të këtij komiteti, Hajredin Luta.

Propozimet që dolën u shtruan në votim për aprovim dhe u aprovuan me shumicën e votave Për, Kundër ishte Bekim Koxha, Abstenuan anëtarët nga LVV. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për ndryshim plotësimin e Komitetit për Komunitete të datës 24 Janar 2018, ashtu që me ndryshim plotësimet, Komiteti për Komunitete ka këtë përbërje 7 anëtarë, me këtë përfaqësim:

1. Lirije Luta,	nga	PDK	anëtar,
2. Kaltrina Tafili	nga	LVV	anëtar,
3. Nazife Krasniqi	nga	LDK	anëtar,
4. Hajredin Luta	nga	AAK	anëtar,
5. Shemsedin Abazi	nga	KDMLNJ	anëtar dhe
6. Elmihane Krasniqi-Malsiu	nga	HANDIKOS	anëtar.
7. Naim Hysa	nga	Kryqi i Kuq	anëtar.

Kryesuesi i Komisionit zgjidhet nga radhët e anëtarëve.

4. Propozim Vendimi për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB);

Kryesuesi i Kuvendit, Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është lista me emrat e bashkangjitur. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Raka, Theksoj se Listës i mungojnë tre emra(përfaqësuesi nga komiteti jo shumicë, përfaqësuesi i Komitetit për Komunitete dhe përfaqësuesi nga OJQ).

Kryesuesi i Kuvendit, Të OJQ, përfaqësues është, Kijani Sallahu, në bazë të Pëlqimeve të tri OJQ tjera që i kanë sjellë me shkrim.

z. Adnan Reka, Arsyja që është shtyrë ky Propozim Vendim, ka qenë se disa emra të cilët e përfaqësojnë këtë Këshill, nuk kanë qenë të njohur për ne.

Kryesuesi i Kuvendit, Meqë nuk ka kush diçka tjetër, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishin 6 anëtarë, Abstenoj 1. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës, mori këtë:

VENDIM

Për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).

5. Propozim Vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të paspenzuara nga vitet paraprake, për shpenzim me buxhetin e vitit 2018;

Kryesuesi i Kuvendit, Kjo pikë e rendit të ditës është shqyrtuar edhe në mbledhjen e KPF, paraprakisht fjalën ia jap drejtorit të DEFZH, Bahri Selimi.

z. Bahri Selimi Theksoj së sipas LFPP, është obligim që bilancet e paspenzuara të bartën në vitin vijues buxhetor për shpenzim. Në vazhdim drejtori sqaroj për shumën e mjeteve të ngelura dhe pozicionet se nga kanë mbetur mjetet, ndërkaq shtoj se mjetet e pa alokuara nuk i kemi në tabelë, port të njëjtat bartën automatikisht. Shuma e mjeteve të paspenzuara nga

v.2017 është 244.455.28€, me çka buxheti aktual i komunës në shumë 7,737.844€ për vitin 2018, shënon rritje për shumën e mbetur dhe bëhet, 7,982.299.28€, ndërkaq shpërndahet ; Mallra e Shërbime, 5,234,38€, Shpenzime Komunale, 2,94€, Subvencione dhe Transfere, 8,304.35€ dhe Investime Kapitale, 230,913,61€.

Drejtori, sqaroj edhe për mjetet që barten nga projektet duke i dhënë me shuma, pozicionet ku do të bartën ashtu si janë paraqitur në tabelë në pjesën bashka-njitetëse të Propozim Vendimit, dha arsyet e mbetjes së mjeteve nga projektet e parealizuara dhe atyre të realizuara, ndërkaq shtoj se mjetet e ngelura të Arsimi dhe të Shëndetësia, mjetet nuk guxojnë të bartën në programe të tjera buxhetore.

Kryesuesi i Kuvendit, I dëgjuat sqarimet e drejtorit, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Të Pasqyra e tabelave, Shtojca B, tabela 2, unë kam paqartësi në shpërndarjen e mjeteve buxhetore tek projektet: Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale, renovimi objekteve dhe infrastrukturës shkolllore, ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike, ndërtimi i rrjeteve të ujësjellësit dhe të renovimi i objekteve në zyrat e administratës komunale, sepse nuk janë specifikuar projektet ku do të investohet me mjetet e parapara.

znj. Fatijona Kyçyku, Në shpërndarjen e mjeteve për investime kapitale të mbetur nga vitet paraprake, ka shumë paqartësi në disa pika ku nuk ka transparencë të mjaftueshme. Tek pika nr.4. Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale, Pika nr.5 Renovimi i objekteve dhe infrastrukturës shkolllore, Pika nr.8 Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike, Pika nr.9 Ndërtimi i rrjeteve të ujësjellësve. Këto pika nuk janë te detajuara mjaftueshëm, nuk dihet në cilat objekte dhe rrugë do te shkojnë investimet.

Dhe pasi analizova vendimin për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara në buxhetin e komunës, shuma që është ndarë për renovimin e objekteve në zyrat e administratës komunale, do të kërkoja qe kjo shumë të iu jepet Handikos pasi që nga këto të dhënat e juaja ne nuk po e dimë se a janë të nevojshme dhe emergjente këto investime.

Personat me aftësi të kufizuar vazhdojnë të përballen me vështirësi në aksesin e arsimit, punësimit, kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve sociale.

z. Selim Reka, Pajtohem me vërejtjet e parafolëse, ndërkaq të shpenzimet, propozoj të shpërndahen për rehabilitimin e rrugës, "Avdurrahim Shehu" e cila rrugë është në gjendje të keqe për shkak të rrëshqitjes së dheut, njëjtë është edhe në rrugën në f. Llanishtë, edhe kjo rrugë ka nevojë me u rehabilituar.

Mjetet buxhetore për Mallra dhe Shërbime në shkollën fillore " Emin Duraku " dhe në SHM " Skënderbeu ", një pjesë e mjeteve po shkojnë për lëndë djegëse-dru, kështu që nuk po mbesin shumë mjetet për nevoja të tjera të shkollës.

znj. Nazife Krasniqi, Pajtohem me parafolësin lidhur me vërejtjet të cilat potencojoj, gjithashtu edhe me mendimin e Ekrem Kyçyku, për specifikim të projekteve, sepse kur nuk ceket një shpenzim, lënë hapësirë për keqpërdorime. Ndërkaq projekte që duhet intervenohet me disa mjetet buxhetore të ngelura nga projektet, është, Përroi në afërsi të qendrës Kaçanik, sepse dihet nga të reshurat atmosferike , përroi ka dalë nga shtrati.

z. Bekim Koxha, Unë mendoj se për mjetet buxhetore të ngelura nga viti 2017, të cilat bartën në vitin 2018, duhet me pasur me shumë transparencë dhe me dhënë shumë detaje.

për projektet në të cilat shpërndahen këto mjete, si p.sh. Mjetet që shkojnë në rehabilitim të rrugëve, duhet me u cekur me emra rrugët të cilat do të rehabilitohen e kështu me radhë.

z. Ekrem Raka, Për mendimin tim nuk është në rregull që Kuvendi i Komunës me pasur buxhetin 6.000€ në vitin 2018 për mallra e shërbime, ndërkaq me intereson të di, a ka mundësi me bërë diçka nga shuma e mjeteve të ngelura nga sektorët tjerë, që me u shtuar mjetet buxhetore për mallra e shërbime të Zyra e Kuvendit, në mënyrë që të intervenohet në projektin, Pajisja e sallës së kuvendit me foltore dhe pajisje të tjera të nevojshme.

Të mjetet buxhetore për shpenzime kapitale, unë nuk po prejudikoj, por këto mjete janë të qytetarëve të komunës, kështu që duhet të bëhet një ndarje e drejtë e tyre, e jo sipas hartës ku është pozita.

Kryesuesi i Kuvendit, Jep sqarime të nevojshme se nga kanë ngelur mjetet. Ai theksoj se një pjesë e mjeteve që janë këtu destinohen për disa projekte të cilat kanë ngelur në gjysmë pa u realizuar, si projekti të, Ura e Dalloshëve, i cili projekt janë ndërprerë punimet për shkak të kushteve atmosferike, kështu mjetet e Ministrisë janë shpenzuar, ndërkaq mjetet buxhetore të komunës bartën për shpenzim në këtë vit për të njëjtin projekt. Edhe të Përroi është e njëjta çështje. Të Objektet e administratës komunale, edhe salla e kuvendit është pjesë e objektit të administratës komunale. Ne e dimë se këto mjete nuk janë të mjaftueshme, por jemi duke i rishqyrtuar mundësitet që me Rishikim buxhetor ta shtojmë këtë vlerë dhe ta bëjmë renovimin e sallës së KK dhe pajisjen e saj, ndërkaq mjetet që janë për objektin e administratës komunale, janë për nevoja ku duhet të intervenohet nga rasti në rast.

z. Bahri Selimi, Projektet janë në harmoni me listën sipas kodeve të cilat i përmbajnë. Të projektet për objektin e administratës lokale, projektet janë obligime për renovimin e zyrave komunale të cilat janë përfunduar dhe këto mjete bartën për me u paguar obligimet. Këtë do ta shihni edhe në Raportin të cilin do ta prezantojmë në mbledhjen vijuese të KK. Të rrugët lokale janë kodi i përgjithshëm, ndërkaq shpërndarja e tyre ka me u bërë me vendime të veçanta të cilat do t'i miratoni ju, me çka shumica e renovimeve shkojnë në rehabilitimin e rrugëve urbane në qytet, e më pak të ato rurale.

Të renovimi i objekteve shkollore, pati arsyen z. Selim Reka, ne kemi paraparë mjete për këtë projekt me buxhet të vitit 2018, ndërkaq kësaj shume ia shtojmë edhe shumën e mjeteve të ngelura nga v. 2017, ndërkaq ne nuk i kemi orientuar nevojat për një shkollë të caktuar, ju jeni ata të cilët vendosni se në cilën shkollë ka nevojë me shkuar këto mjete. Nga diskutimet publike është dhënë propozim të intervenohet në shkollën e Ivajës, mirépo aty mund të pritet ndonjë donacion. Të Handikosi, sa herë e kemi financuar në mënyra të ndryshme, me buxhet i kemi aprovuar shumë projekte të tyre. Nëse ju vendosni ndryshe nuk ka problem. Të vërejtjet të cilat i dha Bekimi dhe Nazifja, projektet janë të përgjithshme, ndërkaq përsëri si të veçanta do të vinë në KK dhe ju jeni ata të cilët vendosni.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, kështu ky Propozim Vendim u shtrua në votim për aprovim dhe u aprovua me 22 votë Për, Kundër ishin 5 anëtarë. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës, mori këtë:

VENDIM

Për bartjen e mjeteve vetanake të paspenzuara në shumë 244.455.28€ nga vitet paraprake, për shpenzim me buxhetin e vitit 2018.

6. Propozim Vendimi për Themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRU“ Bifurkacioni “ – Sh. A. Njësia në Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit, Komisioni duhet të jetë në përbërje, 3 anëtarë, dy anëtarë do të janë nga KK nga subjektet politike me të mëdha dhe 1 anëtar nga Ekzekutivi i Komunës, të cilin anëtar me ligj e cakton Kryetari i Komunës. Atëherë nëse nuk ka kush diçka, shkojmë me propozime konkrete për anëtarë të komisionit të Aksionarëve për KRU“ Bifurkacioni “ – Sh. A. Njësia në Kaçanik;

z. Nexhat Loku, Nga PDK, për anëtar të komisionit të aksionarëve për KRU“ Bifurkacioni “ – Sh.A. Njësia në Kaçanik; e propozoj të jetë, Hamid Guri.

z. Ekrem Kyqyku, Nga LVV, për anëtar të komisionit të aksionarëve për KRU“ Bifurkacioni “ – Sh. A. Njësia në Kaçanik; e propozoj të jetë, Shpend Krusha.

Nënkyetari i Komunës, Nga Ekzekutivi i Komunës për anëtar të komisionit të aksionarëve për KRU“ Bifurkacioni “ – Sh. A. Njësia në Kaçanik; propozoj, Bahri Selimi.

Propozimet të cilat dolën u shtruan në votim për aprovim nga Kryesuesi i Kuvendit dhe u aprovua me një votë Abstenim, atë të, Bekim Koxha. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë :

VENDIM

Për Themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRU“ Bifurkacioni “ – Sh.A. Njësia në Kaçanik, në përbërje:

- | | |
|------------------|---------------------------|
| 1. Hamid Guri | nga PDK, |
| 2. Shpend Krusha | nga LVV dhe |
| 3. Bahri Selimi | nga Ekzekutivi i Komunës. |

7. Propozim Vendimi për Themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM “ Pastërtia “ – Sh. A. Njësia në Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit, Edhe këtu është njëjtë përfaqësimi, 2 anëtarë do të janë nga subjektet politike me të mëdha, por PDK në këtë rast vendin e saj ia ka lënë subjektit politik në kualicion AAK., ndërkaq një anëtar do të jetë nga Ekzekutivi i Komunës. Nëse nuk ka kush diçka e hapi diskutimin: Nëse nuk ka kush diçka, atëherë shkojmë me propozime konkrete;

z. Nexhat Loku, Nga AAK e propozoj për anëtar të komisionit të Aksionarëve për KRM “ Pastërtia “ – Sh. A. Njësia në Kaçanik, të jetë, Afërdita Horuni.

z. Ekrem Kyçyku, nga LVV e propozoj për anëtar të komisionit të Aksionarëve për KRM “ Pastërtia “ – Sh. A. Njësia në Kaçanik, të jetë, Adnan Reka.

Nënkyetari i Komunës, Nga Ekzekutivi i Komunës e propozoj për anëtar të komisionit, të aksionarëve për KRM “ Pastërtia “ – Sh. A. Njësia në Kaçanik, të jetë, Ukshin Qallaku.

Propozimet të cilat dolën u shtruan në votim për aprovim nga Kryesuesi i Kuvendit dhe u aprovua me një votë Abstenim, atë të, Bekim Koxha. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë :

VENDIM

Për Themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM “ Pastërtia “ – Sh.

A. Njësia në Kaçanik, në përbërje;

1. Afërdita Horuni nga AAK,
2. Adnan Reka nga LVV dhe
3. Ukshin Qallaku nga Ekzekutivi i Komunës.

8. Propozim Vendimi për Themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për NPK “Stacioni i Autobusëve” SH.A. Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit, Të ky komision, dy anëtarë do të janë nga KK nga dy subjektet politike me të mëdha, PDK dhe LVV dhe një anëtarë nga Ekzekutivi i Komunës. Nëse nuk ka kush diçka, shkojmë me propozime konkrete:

z. Nexhat Loku, E propozoj për anëtar të komisionit të aksionarëve për NPK “Stacioni i Autobusëve” SH.A. Kaçanik, të jetë, Ahmet Luma.

z. Ekrem Kyçyku, E propozoj për anëtar të komisionit të Aksionarëve për NPK “Stacioni i Autobusëve” SH.A. Kaçanik, të jetë, Fatijona Kyçyku.

Nënkyetari i Komunës, Nga Ekzekutivi i Komunës e propozoj për anëtar të komisionit, të Aksionarëve për NPK “Stacioni i Autobusëve” SH.A. Kaçanik, të jetë, Ramadush Osmani.

Propozimet të cilat dolën u shtruan në votim për aprovim nga Kryesuesi i Kuvendit dhe u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë;

VENDIM

Për Themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për NPK “Stacioni i Autobusëve” SH.A. Kaçanik, në përbërje si vijon:

1. Ahmet Luma nga PDK,
2. Fatijona Kyçyku nga LVV dhe
3. Ramadush Osmani nga Ekzekutivi i Komunës.

9. Propozim Vendimi për formimin e Komisionit për emërimin dhe riemërimin dhe shqyrtimin e ankesave të rrugëve lokale;

Kryesuesi i Kuvendit, Të ky komision sipas dispozitave ligjore, 3 anëtarë do të janë nga Kuvendi i Komunës nga 3 subjektet politike me të mëdha; PDK, LVV dhe LDK, ndërkakq 2 anëtarë do të janë nga Ekzekutivi i Komunës. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

znj. Kaltrina Tafili, Mendoj se kjo çështja e emërit të rrugëve është një çështje sa e rëndësishme aq edhe e ndjeshme. Është e rëndësishme jo vetëm në aspektin teknik të rregullimit (si adresë formale) por edhe për shkak se për emërimin e tyre zakonisht po përdoren emra të përveçëm personash të cilët duhet të kenë dhënë ndonjë kontribut në të mirë të shoqërisë e të kombit, apo të datave a ngjarjeve të rëndësishme historike. Është e ndjeshme, ngase zgjedhja e emrave të pavend shkakton deformim të historisë dhe me këtë edhe lëndim të ndjenjave të qytetarëve.

Të gjitha këto i them, sot këtu në kohën kur po vendoset për përbërjen e këtij komisioni i cili do të emëroj a riemëroj disa rrugë të reja apo të paemëruara e do të shqyrtoj disa ankesa të bëra nga qytetarët, në mënyrë që t'i ketë këto shumë parasysh e ta kryej punën me

profesionalizëm më të lartë dhe me etikë njerëzore e kombëtare, ngase për aq sa kemi njohuri emërtimet e bëra në legjislaturën e mëparshme kanë shkaktuar shumë pakënaqësi, dhe sipas gjykimit pothuaj të përgjithshëm, janë bërë në mënyrë shumë të pa duhur, duke vënë emra shpesh herë edhe të personave të cilët nuk i kanë dhënë ndonjë kontribut shoqërisë.

Mendoj po ashtu që, duke qenë se ne këtu në këtë kuvend jemi zgjedhur me votë qytetare dhe nuk jemi kualifikuar sipas ndonjë përzgjedhjeje bazuar në përgatitjen profesionale, komisioner sipas nevojës duhet të kërkoj ndihmë profesionale nga historian, gjuhëtar, veprimtarë e persona të tjerë të cilët mund të jalin ndihmën e tyre në vlerësimin e rasteve të propozuara, gjersa duhet t'i paraqes në mënyrë të saktë dhe rigorozë kriteret për këto emërimë të cilat duhet të respektohet rreptësishtë.

z. Kemal Mërseli, Dihet se si kanë ardhur deri me tanë disa nga emërtimet, si pasojë e një përfaqësuesi të një zyre. Ekziston Udhëzimi Administrativ për procedurat e emërimeve dhe riemërimeve të rrugëve lokale. Komisionet kanë vepruar sipas propozimeve të fshatrave, ndërkaq problemet që kanë ndodhë se nuk janë zhvilluar procedurat nga administratorët e fshatrave. Vendimet që do të merren duhet të janë të qëndrueshme. Çdo dëmtimi i emërtimit të rrugëve, paraqet shkelje të Vendimit të KK dhe kjo shkelje është vepër penale. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Nexhat Loku, Në vendimin e mëhershëm, dihet ka ekzistuar një, Listë rezervë. Unë kam propozuar që ajo listë të vjen në KK dhe të futën në të emrat e të gjithë dëshmorëve të komunës. Sa i përket dëmtimeve të emërimeve të rrugëve lokale, besoj se praktikat e këqija nëse vendosim konform procedurave, tanë e tutje nuk do të ndodhin.

Kryesuesi i Kuvendit, Komisioni për çfarëdo parregullsie, raporton para KK, Unë ia kisha lënë Komisionit me i zhvilluar procedurat dhe vendosë, pastaj kur të vjen çështja në KK ne e shqyrtojmë. Nëse nuk ka kush diçka, atëherë shkojmë me propozime konkrete për anëtar të komisionit;

z. Nexhat Loku, Nga PDK e propozoj të jetë anëtar i komisionit për emërimin dhe riemërimin dhe shqyrtimin e ankesave të rrugëve lokale, të jetë, Sali Malsiu.

z. Ekrem Kyçiku, Nga LVV e propozoj për anëtar të komisionit, për emërimin dhe riemërimin dhe shqyrtimin e ankesave të rrugëve lokale, të jetë, Shpend Krusha.

z. Selim Reka, Nga LDK, e propozoj për anëtar të komisionit për emërimin dhe riemërimin dhe shqyrtimin e ankesave të rrugëve lokale, të jetë, Besnik Salihu.

Nënkryetari i Komunës -Ylber Bajra, Nga Ekzekutivi i Komunës për anëtarë të komisionit për emërimin dhe riemërimin dhe shqyrtimin e ankesave të rrugëve lokale dy anëtarë i propozoj të janë: 1. Festim Neziraj dhe 2. Menduh Krasniqi.

Propozimet u shtruan në votim dhe të njëjtat u miratuan njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për formimin e Komisionit për emërimin dhe riemërimin dhe shqyrtimin e ankesave të rrugëve lokale, me këtë përbërje:

1. Sali Malsiu nga PDK,

2. Shpend Krusha nga LVV,
 3. Besnik Salihu nga LDK,
 4. Festim Neziraj nga Ekzekutivi i Komunës dhe
 5. Menduh Krasniqi nga Ekzekutivi i Komunës.

10. Propozim Vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm të pjesës së parcelës kadastrale Nr. 00246-0, Z.K Soponicë, e evidentuar në emër të Esat Xhemal Guri nga f. Nikaj, për zgjerimin e lokacionit të varrezave të dëshmorëve;

Kryesuesi i Kuvendit, Për këtë pikë sqarime të nevojshme do të jap drejtori i DUKMM, Ukshin Qallaku.

z. Ukshin Qallaku, Sqaroj se prona i është marrë me herët pronarit, por nuk është bërë shpronësimi. Procedura e shpronësimit gjithsesi duhet të përfundohet, ndërkaq është mirë që pala nuk na ka paditur deri me sot.

Kryesuesi i Kuvendit, I dëgjuat sqarimet e drejtorit, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Bekim Koxha, A është vënë në rrrethojë ajo pjesë e pronës me interes publik e cila është propozuar të shpronësohet.

z. Ukshin Qallaku, Pjesa e pronës e cila është propozuar të shpronësohet për shkak të interesit publik, është brenda rrrethojës, por çështja është se nuk i kemi zhvilluar procedurat e shpronësimit.

Kryesuesi i Kuvendit, Meqë nuk ka kush diçka tjetër, atëherë Propozim Vendimin për shpronësim e pronës me interes publik e shtroj në votim për aprovim. Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë :

VENDIM

Për shpalljen e interesit të përgjithshëm të pjesës së parcelës kadastrale Nr. 00246-0, Z.K Soponicë, e evidentuar në emër të Esat Xhemal Guri nga f. Nikaj, për zgjerimin e lokacionit të varrezave të dëshmorëve.

11. Propozim Vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm të parcelës kadastrale Nr. 01507-0 në vendin, "Guri i Zi" Z.K Biçec, PSH, Ekonomia Pyjore në Kaçanik, për ndërtimin e objekteve publike;

Kryesuesi i Kuvendit, Për sqarime të nevojshme në këtë pikë, fjalën e ka drejtori i DUKMM, Ukshin Qallaku.

z. Ukshin Qallaku, Sqaroj në emër të kujt është prona dhe arsyet e shpalljes me interes të përgjithshëm. Prona është në emër të Ekonomia Pyjore, ndërkaq është propozuar me shpall me interes të përgjithshëm, për mos me u shitur nga AKP. Prona shërben për Parkun nacional për ndërtimin e objekteve publike. Plan detali nuk kemi për momentin, por mendojmë të bëjmë në ndërkohë.

Kryesuesi i Kuvendit, I dëgjuat sqarimet e drejtorit, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Parashtroj pyetje për pronën në fjalë lidhur me zonën në fjalë se ku gjendet.

z. Ukshin Qallaku, Prona në fjalë kufizohet me Parkun, por nuk është pjesë e parkut nacional.

Kryesuesi i Kuvendit, Meqë nuk ka kush diçka tjetër, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për shpalljen e interesit të përgjithshëm të parcelës kadastrale Nr. 01507-0 në vendin, "Guri i Zi" Z.K Biçec, PSH, Ekonomia Pyjore në Kaçanik, për ndërtimin e objekteve publike.

12. Propozim Vendim paraprak për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, parcela kadastrale Nr. 00565-0, Arë e klasës të 3 (Tretë), ZK Bob, në emër të Esat Dema

Kryesuesi i Kuvendit, E njoftoj KK se është në obligim të komunës me marrë një Vendim Paraprak, pasi prona është e klasës të tretë, ndërkaq në bazë të vendimit që do ta marrim ne sot zhvillohen procedurat të tjera nga MBPZHR. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Bekim Koxha, Parashtroj pyetje lidhur me lokacionin e pronës në fjalë se ku gjendet.

z. Ukshin Qallaku, Sqaroj se prona në fjalë gjendet të Ura në Kaçanik. Ajo pronë në fakt nuk është pronë bujqësore. Korrigimet do t'i bëjmë me hartat zonale.

Kryesuesi i Kuvendit, Komisionet janë profesionale nga DBPZHR, nëse ata nuk e kishin parë të arsyeshme me e proceduar, atëherë kishin dhënë mendim negativ.

z. Ekrem Raka, A jeni ju të pajtimit që DUKMM duhet me i bërë këto ndryshime të destinimit të pronës nga toka bujqësore në tokë ndërtimore ?

z. Kaltrina Tafili , Në lidhje me çështjet e ndërrimit të destinimit të tokave, së pari ne nuk kemi të dhëna të mjaftueshme për t'i shqyrtau këto raste ngase na janë dërguar vetëm të dhënat tekstuale por jo edhe ato grafike e vizuale nga ku ne do të mund t'i gjeni më lehtë dhe të mësonim më shumë se për ku dhe për çka është më konkretisht fjala.

Megjithatë, parimisht mendoj se komuna duhet të ketë politika më të përgjithshme në lidhje me trajtimin dhe organizimin e territorit të vet që ka nën juridiksion si urban ashtu edhe rural, e këtu edhe për ngastra (parcela) të veçanta. Ekziston një Plan i Zhvillimit Komunal (2010) dhe të gjitha këto ndryshime duhet të janë në harmoni me atë plan e jo të bëhen vendime të pjesshme sipas kërkësave individuale, ngase kështu po krijohet kaos në zhvillimin jo vetëm urban por edhe rural.

Pra thjeshtë, komuna duhet të ketë plan më të gjithmbarshëm si për zona të veçanta të caktuara ashtu edhe për tërësinë komunale dhe realizimi i kërkësave individuale të bëhet në harmoni me këto plane.

z. Bekim Koxha, drejtori është dashur me herët me na njoftuar me Certifikatat e pronës në mënyrë që me qenë të përgatitur se ku gjenden pronat në fjalë.

z. Ukshin Qallaku, Po të ishin këto prona me PZHU prona ndërtimore, ne nuk i kishim sjellë këtu këtë Propozim Vendim, ndërkaq sqaroj se aty në atë pjesë veç ka plan zhvillimor komunal.

Kryesuesi i Kuvendit, Kujtoj se është e paarsyeshme me i penguar njerëzit me ndërtuar në ato lokacione ku ka ndërtime. Meqë nuk ka kush diçka tjetër, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua me votën Abstenim të Bekim Koxha. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Paraprak për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, parcela kadastrale Nr. 00565-0, Arë e klasës të 3 (Tretë) ,ZK Bob, në emër të Esat Dema

13. Propozim Vendim paraprak për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, parcela kadastrale Nr. 00203-5, Arë e klasës të 3 (Tretë) ,ZK Bob, në emër të Kemajl Dema;

Kryesuesi i Kuvendit, Për sqarime të nevojshme në këtë pikë fjalë e ka drejtori i DUKMM, Ukshin Qallaku.

z. Ukshin Qallaku, Sqaroj se prona në fjalë gjendet në mes të pronave të banimit.

Kryesuesi i Kuvendit, Meqë nuk ka kush diçka, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim. Rezultati i votimit, 26 votë Për, Kundër ishte, Bekim Koxha. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Paraprak për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, parcela kadastrale Nr. 00203-5, Arë e klasës të 3 (Tretë) ,ZK Bob, në emër të Kemajl Dema.

14. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të ngastrave kadastrale 183-2; 183-1; 182-0; 180-6; dhe 180-7, në ZK Bob, nga toka bujqësore në tokë ndërtimore- zonë ndërtimi, banim e afarizëm.

Kryesuesi i Kuvendit, Për sqarime të nevojshme në këtë pikë fjalë e ka drejtori i DUKMM, Ukshin Qallaku.

z. Ukshin Qallaku Sqaroj se prona në fjalë është pa kategori të caktuar-pa klasë, me kulturë "Shpellë", sqaroj për Zonën Kadastrale të pronës etj.

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka, për këtë pikë e hapi diskutimin:

z. Ekrem Raka, Me intereson të dijë, a lejohet me plane zhvillimore të komunës me u bërë ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në këtë Zonë Kadasrale, pasi në Propozim Vendim janë potencuar planet zhvillimore të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit, Pasi prona në fjalë nuk është me Plan zhvillimor, tokë ndërtimore, e kemi sjellë këtu.

z. Selim Reka, Kjo dallon nga pronat tjera të cilat lejohen ndërrimi i destinimit për shtëpi banimi, ndërkaq këtu destinimi i ndërtimit është afarizëm. Ne e dimë se tani kanë u bërë hartat zonale dhe bash ky objekt mund të na prishë punë në planet zhvillimore.

z. Ukshin Qallaku, Në atë zonë, iu njoftoj se nuk lejohen ndërtime mbi 2 kate.

Kryesuesi i Kuvendi, Diskutime të tjera nuk pati. Kështu kjo çështje u shtrua në votim dhe e njëjtë u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishin 5, Abstenuan 5. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për ndërrimin e destinimit të ngastrave kadastrale 183-2; 183-1; 182-0; 180-6; dhe 180-7, në ZK Bob, nga toka bujqësore në tokë ndërtimore- zonë ndërtimi, banim e afarizëm.

Para se më përfunduar takimi, Kryesuesi i Kuvendit i bëri dy Njoftime;

1. Njoftimin e Zyrës për Barazi Gjinore për një takim të caktuar me anëtarët femra të KK, i cili takim do të mbahet në sallën e KK menjëherë pas mbledhjes së KK.
2. Njoftimin me afatin e përcaktuar ligjor për, Deklarim të pasurisë të zyrtarëve të lartë publik, përfshirë edhe anëtarët e KK. Ky është deklarim i rregullt vjetor i pasurisë që bëhet në Agjencionin Antikorupsion nga 01 Mars -31 Mars në çdo vit. Kështu që ta keni parasysh çështjen e deklarimit të pasurisë në afatin e përcaktuar ligjor. Meqë anëtarët e zgjedhur e kanë deklaruar pasurinë me marrjen e detyrës, nuk e di a duhet të deklaroni apo jo pasurinë në afatin e rregullt vjetor, kështu duhet të siguroheni për këtë çështje.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu Kryesuesi i Kuvendit në ora: 13:07 e konstatoj mbledhjen të përfunduar. Deri në përfundim të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët e KK, ndërkaq Kryetari i Komunës-Besim Ilazi me një pjesë të stafit të tij prezantuan vetëm në pjesën e parë të mbledhjes, për shkak të një, Manifestimi përkujtimor të organizuar në shënimin e 19 vjetorit të betejës së 28 shkurtit 1999 në Gajre.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu
2014/19/06

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 207);

**nga Mbledhja e II (Dytë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin
2018, mbajtur me 28 Shkurt 2018.**

1. Kemal Mërseli.....,
2. Hamid Guri.....,
3. Ahmet Luma
4. Kadri Krivenjeva,.....,
5. Besim Vishi,.....,
6. Sali Malsiu.....,
7. Lirije Shurdhani.....,
8. Pranverë Loku- Zharku.....,
9. Lirije Luta.....,
10. Vlora Dalloshi.....,
11. Nexhat Loku
12. Shpend Krusha.....,
13. Adnan Reka.....,
14. Ekrem Kyçyku.....
15. Fatijona Kyçyku.....,
16. Kaltrina Tafili
17. Selim Reka.....,
18. Besnik Salihu,.....,
19. Nazife Krasniqi.....,
20. Arlinda Rakoci-Raka.....,
21. Shemsedin Luzha.....,
22. Albana Troni.....,
23. Afërdita Shehi,.....,
24. Hajredin Luta.....,
25. Hafize Sallahi
26. Bekim Koxha.....,
27. Ekrem Raka,.....,